

## 2.1 SHKARKIMI I REGJISTRIMIT NGA BAZA E PËRBASHKËT E TË DHËNAVE

Në bazën lokale të të dhënave mund të shkarkoni regjistrimin nga baza e përbashkët. Mirëpo, për këtë procedurë nevojitet leje e posaçme, të cilën nuk mund t'ua japë administratori i aplikacioneve lokale.

### *Kushti*

Shkarkimin e regjistrimit mund ta bëjnë përdoruesit, të cilët kanë lejen *Shkarkimi i regjistrimit nga baza e përbashkët në bazën lokale të të dhënave (KAT\_SHR)*.

### *Procedura*

1. Në klasën Materiali, përzgjidhni metodën **Klasa / Shkarko në bazën lokale të të dhënave regjistrimin nga baza e përbashkët**.  
Do të hapet dritarja për kërkim e regjistrimeve bibliografike në bazën e përbashkët të të dhënave, ku do të kërkoni dhe përzgjidhni regjistrimin bibliografik.
2. Dritarja për redaktimin e të dhënave lokale bibliografike do të hapet.  
Futni të dhënat lokale dhe pastaj ruani ato (shih kapitullin 2.2).
3. Do të hapet dritarja për kërkim e regjistrimeve bibliografike në bazën e përbashkët e dhënave bibliografike, ku sërish mund të kërkoni dhe përzgjidhni regjistrimin bibliografik.  
Procedura në pikat 2 dhe 3 mund t'i përsëritni disa herë.
4. Për të përfunduar këtë procedurë, klikoni butonin **Mbyll** në dritaren për kërkim të regjistrimeve bibliografike.

### *Mundësitë ...*

Nëse nga dritarja për kërkim në bazën lokale të të dhënave duke klikuar butonin **COBIB.XX** kaloni në dritaren për kërkim të bazës së përbashkët të të dhënave bibliografike, atje mund të kërkoni dhe përzgjidhni regjistrimin e dëshiruar dhe pastaj të vazhdoni me shkarkimin.

Nga baza e përbashkët e të dhënave mund ta shkarkoni regjistrimin bibliografik edhe gjatë shtimit të njësive në dokumentet e pasurimit. Në dritaren për kërkim të materialit, duke klikuar butonin **COBIB.XX** do të kaloni në bazën e përbashkët e të dhënave bibliografike, ku mund ta kërkoni dhe përzgjidhni regjistrimin dhe pastaj të vazhdoni me shkarkimin.